



EEN Albania Newsletter

1. "Balkan Technology Match 2018"

Në 7-8 qershor 2018, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, në bashkëpunim me Rrjetin e Ndërmarrjeve Evropiane në Maqedoni, bashkëorganizoi aktivitetin "Balkan Technology Match 2018", kjo ngjarje ndërmjetësimi u përqendrua në rritjen e shkallës së teknologjisë të kompanive duke ofruar një mundësi për të takuar partnerët e ardhshëm dhe investitorët potencialë.

Ku aktivitet u organizua në kuadër të Konferencës IT-së të Ballkanit, e cila është përshtatur për sipërmarrës të interesuar në rritjen e kompanive të tyre.

07 – 08 Qershor



2. "Aksesi në Financë"

Është zhvilluar në datën 13 Qershor 2018 në ambientet e Hotel Life Gallery, të qytetit të Korçës seminari me temë Instrumentet financiarë dhe Programet në mbështetje të SME-ve Shqiptare. Ky event u organizua nën kujdesin e veçantë të Programit Italo-Shqiptar për Zhvillimin e SME-ve në Shqipëri në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve-AIDA.

Aktorë të ndryshëm pjesëmarrës në këtë seminar, diskutuan mbi mundësitë e ndryshme për të mbështetur biznesin vendas nëpërmjet skemave të financimit.

Ekspertë të AIDAs bënë prezantime mbi shërbimet e ofruara nga agjencia për fondet grant ku u vu theksi në mbështetjen e biznesit, veçanërisht SME-ve, për të përmirësuar kapacitetet e tyre si dhe hyrjen e tyre në tregjet ndërkombëtare.

13 Qershor 2018



3. Shkodra "Info Day"

Në 20 Qershor 2018, është mbajtur në ambientet e Grand Hotel Europa në qytetin e Shkodrës, seminari me temë "Info Day mbi Rrjetin Europian të Ndërmarrjeve". Ky event u organizua nga AIDA, si partneri udhëheqës në projektin EEN dhe me pjesëmarrjen e përfaqesueses së Agjencisë EASME në BE, Znj. Rebeca De Sancho Mayoral.

Përfaqësuesja e AIDAs Znj. Migena Muslli bëri një prezantim mbi Rrjetin Europian të Ndërmarrjeve, gjatë së cilit u shpjeguan shërbimet dhe funksionet që ofron ky Rrjet si një mundësi e mirë për SME-të shqiptare të gjejnë partnerë strategjikë dhe të zgjerohen në tregje të reja.

20 Qershor 2018



4. Vizitë në kantinën "Arbëri"

Vizite e stafit të EEN - Albania dhe ekspertës së EASME në BE, Znj. Rebeca DeSancho Mayoral, pranë kompanisë "Kantina Arbëri". Kantina Arbëri është një prej kompanive shqiptare më të suksesshme në Rrjetin Europian të Ndërmarrjeve.




5. Summer Academy for SME's

Në datat 25-29 qershor u mbajt Akademia Verore për SME-të mbi trajnimin e "Menaxhim të eksportit" ne ambientet e Tirana International Hotel & ConferenceCentre.

#EENAlbania eshte nje prej bashke partnereve ne kete nisme ne ndihme te SME-ve shqiptare. Nje leksion i mbajtur ne kuader te Akademise Verore per SME, organizuar nga Instituti Shqiptar i SME-ve ne bashkepunim me Ambasaden Hollandeze dhe EEN-Albania.

Ne fund te aktivitetit pjesemarresit u pajisen me certifikate.

25-29 Qershor 2018



6. Info Day

Në kuadër të informimit mbi programet financuese të BE-së dhe të rritjes së mundësisë së bashkëpunimit ndërmjet Industrisë dhe Sektorit Publik, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) në bashkëpunim me Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Inestimeve (AIDA), Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale (DPPI), Unionit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë të Shqipërisë (UCCIAL) dhe Drejtoria për të Drejtën e Autorit (DDA), organizon Ditën Informative me temë: " Programet financuese të BE-së për SME-të, Pronësia Industriale dhe e Drejta e Autorit".

Info day "Programet financuese të BE-së për SME-të, Pronësia Industriale dhe e Drejta e Autorit, 19 Korrik 2018, Tiranë

19 Korrik 2018



Vizitoni:

www.een.al

een.ec.europa.eu

